



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 200, Datë 23.06.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX” SH.A., PËR T’U PËRCAKTUAR SI OPERATORI I EMËRUAR I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 19 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; nenit 3, pika 3 dhe 7 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 06.03.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1395/3 prot., datë 20.06.2023, të Grupit të Punës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., për t’u përcaktuar si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1395, datë 10.05.2023, paraqiti aplikimin për t’u përcaktuar si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- Po ashtu, me shkresat e protokolluara me nr. 1395/1 prot., datë 10.05.2023 dhe nr. 1395/2 prot., datë 02.06.2023, ka depozituar dokumentacion shtesë për këtë aplikim.
- Referuar përkufizimeve të përcaktuara në nenin 2 të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 06.03.2020, Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) është subjekt ligjor i përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës ditë sipas kësaj rregulloreje.
- Nga shqyrtimi që iu bë informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga aplikuesi referuar përcaktimeve të shtojcës 1.a dhe 1.b të Rregullores, rezulton se mbetet për t’u plotësuar dhe dokumentacioni si vijon:

**Neni 4**

**Kriteret për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike**

**Pika 1.** Aplikuesi duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme për t'u përcaktuar si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike:

- **gërma “a”**

**Pika 4** Të paraqesë një plan financiar për të ardhurat që planifikon se i nevojiten për vitin aktual dhe vitin pasardhës. Në këtë plan duhet që në mënyrë të qartë të shprehen supozimet që shoqëria ka marrë parasysh në përcaktimin e këtyre të ardhurave, një analizë studimore që parashikon ndyshimet që mund të vijnë në parashikimin e të ardhurave të kompanisë si dhe një analizë se si aplikuesi parashikon operimin nga pikpamja financiare.

**Pika 5**

c) Të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës që lidhet me procesin e finalizimit të miratimit të strukturës së saj organizative e po ashtu të nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse në lidhje me shërbimin IT, sikurse kërkuar nga kjo pikë e rregullores.

i) h) Të depozitojë në ERE, marrëveshjen tashmë të nënshkruar për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a. tek ALPEX sh.a. për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndërditor dhe kalkulimet e barazimet përfundimtare (Clearing and Settlement), si dhe të japë informacion mbi fazën ku ndodhet nënshkrimi i marrëveshjes operacionale midis KOSTT sh.a. dhe ALPEX sh.a., marrëveshjes për të ardhurat nga kongjestionimi dhe marrëveshjes për klerimin ndërkufitar dhe agjentin e transaksioneve. Marrëveshjet e finalizuara duhet t'i depozitojë në ERE. Shpjegim të detajuar në lidhje me planifikimin e përshtatshëm të menaxhimit të rasteve emergjente dhe trajtimin e këtyre rasteve.

- **gërma “b”**

Të publikojë në faqen zyrtare të internetit çdo metodologji që përdor aktualisht dhe do të përdorë në të ardhmen.

- **gërma “c”**

Pikat 1, 2, 3 dhe 4

Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Përshkrim të qartë dhe shpjegim të proceseve të llogaritjes të cilat do t'i japin mundësinë aplikuesit të identifikojë dhe ndajë kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);

- Përshkrim të qartë dhe shpjegim të llogarive të veçanta të cilat do të përdoren për kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
- Përshkrim të qartë të proceseve të raportimit të një analizimi të qartë të të gjitha kostove të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë shpenzimet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO);
- Një krahasim i kostove të aplikuesit në lidhje me shembujt respektivë në Bashkimin Europian (BE) me kosto të ndara të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO).

- **gërma “d”**

Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE:

- Deklaratë nëse është duke bashkëpunuar me palë të tjera dhe nëse po, çfarë aktiviteteve po ndërmerr me këto palë;
- Një përmbledhje të plotë të të gjitha insitucioneve në vartësi funksionale të pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
- Informacion në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotëruesve direktë dhe indirektë, palë të tjera të lidhura ligjërisht, kompanitë mëmë, dhe filialet e tyre;
- Në rast se aksionerët, palët e tjera ligjore, kompanitë mëmë, ose filialet janë pjesëmarrës të tregut, duhet të shpjegohet sesi aplikuesi ka organizuar ndarjen e biznesit dhe eliminimin e konfliktit të interesit.

- **gërma “e”**

Aplikuesi duhet të përcjellë në ERE shpjegimet relevante të procesve operative të secilit aktivitet dhe llogaritë përkatëse dhe dokumentacion vërtetues mbi ndarjen e llogarive për të gjitha funksionet që ushtron.

- **gërma “f”**

Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE:

- Një shpjegim të detajuar të procedurave për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar dhe që do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk lejojnë diskriminimin e pjesëmarrësve të tregut;
- Informacion mbi procedurat e brendshme që duhet të përcaktohen me shkrim si dhe marrëveshjet funksionale, marrëveshjet kontraktore dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese.

- **gërma “g”**

Pika 1 dhe 2.

Aplikuesi duhet të bëjë me dije në cilën fazë ndodhet procedura për miratimin e strukturës organizative dhe në rast se ajo është miratuar tashmë, të depozitojë në ERE interpretimin përkatës të detajuar sipas kërkesave të pikës 1 dhe 2 të këtij neni të rregullores.

- **gërma “h”**

Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE marrëveshjet për transparencën dhe konfidencialitetin me pjesëmarrësit e tregut dhe OST.

- **gërma “i”**

Pika 2, 3 dhe 5.

Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE:

- Përshkrim dhe shpjegim të qartë të proceseve për të vendosur se cilat garanci nevojiten për shlyerje (likuidim).
- Vlerësim të riskut dhe analizë studimore e bërë për të treguar përballimin e riskut në vazhdim.
- Përshkrim të qartë dhe shpjegimin e marrëveshjeve kontraktuale të nevojshme për të siguruar proceset e shlyerjes dhe likuidimit, përfshirë NEMO dhe OST e tjera dhe konfirmimin për marrëveshjet e operimit dhe ato kontraktuale të cilat lejojnë ose do të

mundësojnë NEMO dhe OST e tjera që të funksionojnë në tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe/ose atë brenda të njëjtës ditë.

- **gërma “j” dhe neni 4.2.**

Pika 2 dhe 3

Aplikuesi duhet të depozitojë përshkrim dhe shpjegim të marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimin e menaxhimit të riskut e po ashtu duhet të depozitojë në ERE rregullat përkatëse të dakordësuara me OST sh.a. lidhur me sistemet dhe komunikimin ndërmjet tyre, duke marrë në konsideratë dhe detyrimet që lindin nga Kodi i Transmetimit.

- Për gjithë sa më sipër vlerësohet fillimi i procedurës për përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX”sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe zhvillimi i seancave të mundshme dëgjimore në kuadër të sqarimit të dokumentacionit që mbetet për t’u plotësuar nga ky aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
2. Drejtoria Ligjore dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, si dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**